



## VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

**Data e miratimit: 23.02.2011**

**Nr. i rastit 2010-08**

**Velimir Krstić**

kundër

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 shkurt 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Z. Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 8 shtator 2010. Me 29 dhjetor 2010 Paneli ka kërkuar informata shtesë nga parashtruesi i ankesës. Informatat shtesë janë pranuar me 5 janar 2011.

## II. FAKTET

### Parathënie

2. Parashtruesi i ankesës posedon 0.35.48 hektarë parcelë tokë në Fushë Kosovë. Parcela iu ishte dhënë me qira KFOR-it britanik deri në muajin maj të vitit 2004. Pasi KFOR-i britanik ishte tërhequr nga Kosova, Komuna e Prishtinës kishte marrë përsipër parcelën. Parashtruesit të ankesës nuk iu kishte paguar kompensimi, e as nuk iu kishte kërkuar leje për shfrytëzimin e parcelës së tij.
3. Sipas parashtruesit të ankesës, parcela në fillim ishte shfrytëzuar për deponimin e mbeturinave dhe materialeve të ndryshme. Më vonë, supozohet se Komuna e Prishtinës kishte filluar ndërtimin e një tregu me shumicë në pjesën e parcelës. Sipërfaqja prej 0.12.82 hektarë ishte rrethuar, kështu që parashtruesit të ankesës i ishte ndaluar hyrja në parcelën e tij.

### Procedura civile

4. Me 28 shkurt 2006 parashtruesi i ankesës kishte nisur një padi civile (nr. 291/06) tek Gjykata Komunale e Prishtinës kundër Komunës së Prishtinës. Ai kishte kërkuar kompensim në shumën prej 100.000 eurove. Përveç kësaj, ai kishte kërkuar që rrethoja, mbeturina dhe materiali i fortë të largoheshin nga toka e tij dhe se tarifat ligjore të mbuloheshin nga i padituri. Gjithashtu ai kishte propozuar që Gjykata vetë ta inspektonte vendin.
5. Një inspektim i tillë ishte kryer në praninë e parashtruesit të ankesës, të paditurit dhe Gjykatës më 23 tetor 2009. Dokumentet nga Agjensioni Kadastral tregojnë se parashtruesi i ankesës është pronar i tokës. Sipas parashtruesit të ankesës, gjithsej tre seanca dëgjimore ishin mbajtur nga Gjykata Komunale midis 28 shkurtit 2006 dhe 8 shtatorit 2010. Rasti është ende në pritje dhe nuk janë ofruar hollësi të tjera.

### Procedura penale

6. Duket se disa ndërtesa ishin duke u ndërtuar në parcelën e parashtruesit të ankesës, pa e njoftuar atë apo pa kërkuar lejen e tij për ndërtimet. Ndërtimi i një ndërtese ishte ndaluar nga Shërbimi Policor i Kosovës së bashku me Inspeksionin Komunal për ndërtime. Si pasojë e kësaj, procedura penale ishin ndërmarrë nga Policia e Kosovës më 24 dhjetor 2008 (2008-AD-02133) kundër Kompanisë Publike të Tregut në Prishtinë tek Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë. Kompania ishte dyshuar për uzurpim të paligjshëm të pronës së patundshme.
7. Më 12 shkurt 2009, prokurori kishte hedhur poshtë akuzat me vendimin e tij KTR Nr. 4018-13/2008. Parashtruesi i ankesës ishte këshilluar që të inicioj padi civile kundër personave që po shfrytëzojnë pronën e tij. Nuk dihet se a e ka bërë këtë.

### **Hetimi nga Institucioni i Ombudspersonit**

8. Më 7 gusht 2009 parashtuesi i ankesës ka dorëzuar një ankesë (nr. 353/09) tek Institucioni i Ombudspersonit, duke pretenduar se procedurat tek Prokuroria Komunale në Prishtinë ishin zvarritur shumë.
9. Më 7 maj 2010 ankesa ishte hedhur poshtë, pasi asnjë padi civile nuk ishte iniciuar kundër personave që shfrytëzonin tokën e tij, siç ishte udhëzuar nga prokurori (shih më lart). Ombudspersoni nuk mund ta shqyrtonte rastin, pasi nuk ishin shfrytëzuar mjetet e duhura ligjore.

### **Shqyrtimet dhe diskutimet e tjera**

10. Sipas parashtesave të tij, parashtuesi i ankesës ka pranuar përgjigje negative verbale për kërkesat e tij për të liruar pronën e tij nga autoritetet në vijim:
  - 2 dhjetor 2008, drejtorët nga zyra për komunitete, Sladjana Lazic,
  - 2 dhjetor 2008, drejtor i Zyrës Kadastrale të Fushë Kosovës-Breznica,
  - 19 janar 2009, Gerber Aneet - Zyrtar për Çështje Rajonale të Komunitetit dhe Lejla Kolenovic - Zyrtar Rajonal për të Drejtat e Komunitetit,
  - 5 gusht 2009, Komisioni Këshillëdhënës Gracanica.
11. Përveç kësaj, parashtuesi i ankesës supozohet se është përpjekur të hyj në objektet e Policës së EULEX-it në vitin 2009 në lidhje me rastin e tij, mirëpo iu ishte mohuar hyrja.
12. Nuk janë ofruar dokumentacione apo hollësi të tjera rreth ndonjëres prej këtyre diskutimeve dhe vendimeve, përkundër kërkesës që i është bërë nga Paneli.

### **III. ANKESAT**

13. Parashtuesi i ankesës pretendon se ai ka qenë i diskriminuar nga sistemi i drejtësisë së Kosovës, në veçanti nga gjykatësi në Gjykatën Komunale të Prishtinës, i cili kishte mbajtur tri sesione dëgjimore, kishte ftuar palët e jashtme në sesione rreth padisë civile, dhe në këtë mënyrë kishte vonuar procesin vendimmarrës. Prandaj, supozohet se ai gjithashtu ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurës civile.

### **IV. LIGJI**

14. Para shqyrtimit të ankesës rreth bazueshmërisë në merita, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.

15. Paneli vuri në dukje se në rastin e tanishëm, parashtruesi i kërkesës ka nisur procedurën civile tek Gjykata Komunale e Prishtinës më 28 shkurt 2006. Rasti është ende në pritje në atë gjykatë. Kështu që, procedura ka zgjatur pesë vite deri më tani në një instancë gjyqësore. Një kohëzgjatje e tillë e procedurës mund të cilësohet se nuk përputhet me kërkesën që procedurat civile të dëgjohen brenda një afati të arsyeshëm; kërkesa e cila është element përbërës i së drejtës për proces të drejtë, siç është e përcaktuar nga Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të zbatueshme në Kosovë.
16. Megjithatë, sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli mund t'i shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Rasti për të cilin parashtruesi i ankesës i referohet është në pritje tek Gjykata Komunale e Prishtinës. Nuk është treguar e as argumentuar se ndonjëri prej gjykatësve të EULEX-it ka qenë i përfshirë në çfarëdo kapaciteti në procesin civil të parashtruesit të ankesës.
17. Si pësojë, çështjet e ngritura në ankesën e tanishme nuk bien brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën e tanishme, konstaton se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit